



Periodik mujor Nr. 173 Tetor 2023

**Në
këtë
periodik
do të lexoni:**

**Shqipëria për zgjidhet
si vendi organizator
i Konferencës Vjetore - IAIS 2025**

**VËSHTRIM
MBI TREGJET**

Tregu i Sigurimeve, Janar- Shtator 2023

Tregu me pakicë i titujve të Qeverisë, Janar- Shtator 2023

4-5

ZHVILLIME TË TJERA

**BOTIME
PROFESIONALE**

6 - 12

**INFORMACIONE
NDËRKOMBËTARE**

13-15

**Shqipëria për zgjidhet vendi organizator
i Konferencës Vjetore dhe Mbledhjeve të Komiteteve të
Organizatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve në Sigurime,
IAIS në vitin 2025**



Shqipëria do të mikpresë në vitin 2025 për herë të parë mbi 158 autoritete mbikëqyrëse dhe rregullatore të tregut të sigurimeve nga e gjithë bota, të cilat aderojnë në Organizatën Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve në Sigurime, IAIS. Aktiviteti, më i rëndësishmi për organizatën që përfaqëson mbikëqyrësit ndërkombëtarë, do të organizohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, AMF, në cilësinë e autoritetit mbikëqyrës të vendit pritës.

Kjo është konfirmuar në letrën e dërguar nga Sekretari i Përgjithshëm i IAIS, z. Jonathan Dixon, për Drejtoreshën e Përgjithshme Ekzekutive në Detyrë të AMF-së, zj. Mimoza Kaçi, ku ai informon se Komiteti Ekzekutiv i IAIS ka miratuar kandidaturën e Shqipërisë për organizimin e Konferencës Vjetore, Mbledhjet e Përgjithshme Vjetore, si edhe Mbledhjet e Komiteteve. “Në emër të Organizatës, dua t’ju falënderoj për mbështetjen Tuaj dhe për lidhshimin e treguar,” theksohet në letrën e dërguar nga Sekretari i Përgjithshëm i IAIS, z. Jonathan Dixon.

Në vazhdim, një punë intensive e përbashkët e strukturave të IAIS dhe Autoritetit pritet të përcaktojë dhe detajet e këtij organizimi, i cili gjithashtu do të promovojë më tej Shqipërinë në arenën ndërkombëtare.

Për herë të parë, event i rëndësishëm në nivel global i tregut të sigurimeve, i cili mbledh bashkë institucionet mbikëqyrëse dhe rregullatore, si dhe aktorët më të rëndësishëm ndërkombëtarë të këtij tregu, organizohet në Shqipëri.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, Janar-Shtator 2023


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për muajin janar-shtator 2023 kapën vlerën 17,033 milionë lekë, ose 9.85% më shumë se në janar-shtator 2022. Gjatë periudhës janar-shtator 2023, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 1,093,347 me një rritje prej 11.41% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 92.02% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, sigurimet e Jetës realizuan 7.91% dhe risigurimi realizoi 0.07% të vëllimit të përgjithshëm të primeve. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 39.93% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 60.07% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-shtator 2023, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 4,918 milionë lekë, ose 3.05% më shumë se në periudhën janar-shtator 2022.

Dëmet e paguara bruto në sigurimin e motorik për periudhën janar-shtator 2023 kapën vlerën 3,535 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 7.77% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Struktura e tregut të sigurimeve, Janar-Shtator 2023 (Në %)



Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik, gjatë periudhës janar-shtator 2023 arritën rreth 10,232 milionë lekë, ose 7.19% më shumë se në periudhën janar-shtator 2022.

Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Titujve të Qeverisë për periudhën janar - shtator 2023

Vëllimi i tregut sekondar të titujve të Qeverisë për periudhën janar-shtator 2023, u dominua në masën 67.03% nga transaksione në instrumente afatshkurtër (bono thesari) dhe 32.97% nga transaksionet në instrumente afatgjatë (obligacione). Parë nga këndvështrimi i numrit të transaksioneve, 85.13% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të titujve të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera në bono thesari.

Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të titujve të Qeverisë për periudhën janar-shtator 2023, flasin për një dominim të transaksioneve “Blerje në tregun primar” dhe “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” përkatësisht me 46.81% dhe 41.99% kundrejt vëllimit të përgjithshëm.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të titujve të Qeverisë, për periudhën janar-shtator 2023 dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë 99.19% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.


Transaksionet e grupeve B dhe C

Transaksioni i llojit B “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar” gjatë periudhës janar-shtator 2023, ka pasur një ulje prej 494.16 milionë lekë ose 11.86% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Numri i transaksioneve i llojit B është rritur në masën 37.05%.

Transaksioni i llojit C “Blerje para afatit të maturimit” gjatë periudhës janar-shtator 2023, ka pasur një ulje prej 155.24 milionë lekë ose 5.91%, ndërkohë pati një rritje në numrin e transaksioneve në masën 44.91%, krahasuar me periudhën janar-shtator 2022.

Në totalin e transaksioneve të llojit B dhe C të marra së bashku, vihet re një ulje në vlerë absolute me rreth 649.40 milionë lekë, krahasuar me periudhën janar-shtator 2022.

Tregu me pakicë i titujve të Qeverisë për periudhën, Janar-Shtator 2023 (Në %)



Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik, gjatë muajit janar-shtator 2023 arritën rreth 10,232 milionë lekë, ose 7.19% më shumë se në muajin janar-shtator 2022.

ZHVILLIME TË TJERA

AMF organizoi Konferencën Ndërkombëtare, “Zhvillimi i Sektorit të Sigurimeve – Mundësitë dhe Sfidat në Evropën Juglindore”



Informacion më i plotë gjendet në linku:

https://amf.gov.al/new_s.asp?id=43081

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Bankën Botërore organizoi më 18 tetor në Tiranë, Konferencën Ndërkombëtare “Zhvillimi i Sektorit të Sigurimeve – Mundësitë dhe Sfidat në Evropën Juglindore”. Konferenca mbledhi së bashku përfaqësues të nivelit të lartë të Qeverisë Shqiptare, institucioneve financiare ndërkombëtare, autoriteteve mbikëqyrëse financiare dhe pjesëmarrësve të tregut vendas dhe të huaj. Ajo u organizua në tre panele dhe panelistët ndanë mendimet dhe eksperiencat e tyre në lidhje me tregun e sigurimeve, praktikat botërore dhe nevojën për diversifikimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të sektorit të sigurimeve në Shqipëri dhe në rajon.



Paneli I: Roli i sigurimeve në menaxhimin e riskut të katastrofave”

Tema e panelit të parë ishte “Roli i sigurimeve në menaxhimin e riskut të katastrofave”. Në panelin e drejtuar nga zj. Tatiana Skalon, Eksperte e Financimit të Riskut të Katastrofave në Bankën Botërore, morën pjesë z. Ervin Mete, Ministër i Financave dhe Ekonomisë, z. Yusuf Dinç, Anëtar Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve dhe Pensioneve Private të Turqisë, z. Olivier Mahul, Menaxher i Seksionit të Krizave dhe Financimit të Riskut të Katastrofave në Bankën Botërore dhe z. Conor Donaldson, Drejtues i Zbatueshmërisë në Organizatën Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve në Sigurime (IAIS).

Panelistët diskutuan mbi modelet e aplikuara për skemat e sigurimit nga katastrofat, praktikat më të mira botërore, si edhe zbatimin e tyre në Shqipëri dhe në vendet e rajonit.

Paneli II -“Mundësitë dhe sfidat për zhvillimin e sektorit të sigurimeve në Evropën Juglindore”



Tema e panelit të dytë ishte “Mundësitë dhe sfidat për zhvillimin e sektorit të sigurimeve në Evropën Juglindore”. Në panelin e drejtuar nga z. Peter Braumüller, Nënkryetar i Autoritetit Evropian të Sigurimeve dhe Pensioneve (EIOPA), morën pjesë z. Ahmet Ismaili, Guvernator i Bankës Qendrore të Kosovës, z. Olsi Çoku, Kryetar i Bordit të AMF, zj. Ilijana Jelec, ZvPresidente e Bordit të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Shërbimeve Financiare të Kroacisë dhe z. Branko Barjaktarovic, Drejtor i Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Malit të Zi.

Panelistët diskutuan mbi ecurinë dhe sfidat për zhvillimin e sektorit të sigurimeve në Evropën Juglindore, edhe në kuadër të avancimit dhe harmonizimit të kuadrit ligjor me Direktivat Evropiane dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare.

Informacion më i plotë gjendet në linku:

Paneli II
<https://amf.gov.al/new.s.asp?id=43080>

Paneli III
<https://amf.gov.al/new.s.asp?id=43079>

Paneli III -“Sfidat për zhvillimin e sigurimeve në bujqësi”



Tema e panelit të tretë ishte “Sfidat për zhvillimin e sigurimeve në bujqësi”. Në panelin e drejtuar nga z. Klime Poposki, Kryetar i Bordit Drejtues i Winner, morën pjesë zj. Anila Denaj, Ministre e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, z. Bekir Engürülü, Menaxher i Përgjithshëm, Fondi i Sigurimeve në Bujqësi i Turqisë, z. Andriy Zaripov, Drejtues i Projektit për Sigurimet në Bujqësi nga IFC dhe z. Avni Ponari, Drejtor Ekzekutiv i Sigal Uniqa Group Austria.

Panelistët ndanë eksperiencat e tyre në lidhje me modelet e aplikuara për sigurimet në bujqësi, mundësitë dhe sfidat për zhvillimin e këtij produkti në Shqipëri dhe në vendet e rajonit.

Fjala e Drejtores Ekzekutive në detyrë zj. Mimoza Kaçi në Konferencën Zhvillimi i Sektorit të Sigurimeve – Mundësitë dhe Sfidat në Evropën Juglindore”



Informacion më i plotë gjendet në linku:

<https://amf.gov.al/news.asp?id=43078>

I nderuar, z. Ministër i Financave dhe Ekonomisë,
Të nderuar përfaqësues të Bankës Botërore,
Të nderuar pjesëmarrës,

Kam kënaqësinë që në emër të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare t’ju uroj mirëseardhjen në këtë konferencë të organizuar në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe me mbështjetjen e partnerëve tanë strategjikë, Sekretariatit Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO) dhe Banka Botërore.

Kjo konferencë zhvillohet dy ditë pas Samitit të Procesit të Berlinit, të zhvilluar në Tiranë, i cili kishte ndër të tjera si kryefjalë të tij bashkëpunimin dhe integrimin rajonal mes shteteve të Ballkanit Perëndimor, përfshirë këtu edhe tregjet tona financiare jobankare. Kryetarja e Komisionit theksoi synimin e unionit për Ballkanin Perëndimor, për të na dhënë një qasje në tregun e përbashkët evropian.

Në këtë klimë optimiste për Ballkanin Perëndimor, edhe ky event sot, bën bashkë të gjithë aktorët me rol kyç në zhvillimin e mëtejshëm të sektorit të sigurimeve - në Shqipëri, por dhe më gjerë në rajon.

Dita e sotme paraqet një mundësi të shkëlqyer për të gjithë ne, për të diskutuar dhe reflektuar mbi zhvillimet aktuale, por mbi të gjitha për adresimin e sfidave të përbashkëta me objektiv kryesor: rritjen e potencialit sektorit të sigurimeve në ekonominë tona. Pikëpamjet e rregullatorëve të rajonit, të BE-së, me të cilët do të ndajmë eksperiencat, do të na vlejnjë për të vendosur prioritetet konkrete drejt objektivave tona.

Tregu shqiptar i sigurimeve, në vazhdimësi ka shfaqur tendenca në rritje, në terma të të ardhurave, numrit të kontratatave, aseteve në menaxhim, dhe dëmeve të paguara. Dua të nënvizoj një tregues, primin bruto për frymë, i cili në një periudhë 8 vjeçare është rritur me mbi 80%, shifër që flet për rritjen e tregut dhe ndërgjegjesimin e popullsisë. E megjithatë, tregu i sigurimeve ende mbizotërohet nga produktet e sigurimit të detyrueshëm.

Vijon ...

Fjala e Drejtores Ekzekutive në detyrë zj. Mimoza Kaçi në Konferencën Zhvillimi i Sektorit të Sigurimeve – Mundësitë dhe Sfidat në Evropën Juglindore”



... vijon

Dhe meqë jemi te sigurimet e detyrueshme, zbatimi i ligjit të ri për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit ka sjellë një sërë zhvillimesh pozitive në këtë treg, duke reduktuar ndjeshëm komisionet e ndërmjetësimit, ka përmirësuar situatën e dëmeve të Byroja Shqiptare e Sigurimeve dhe në fund të vitit 2022, numri i dëmeve të paguara ka arritur nivelin më të lartë historik. Tregu i sigurimeve ka treguar qëndrueshmëri ndaj ngjarjeve madhore, duke nisur me dy tërmetet e vitit 2019, pandemia COVID-19, por edhe ndaj efekteve të mjedisit makroekonomik botëror.

Autoriteti, në rolin e tij si mbikëqyrës dhe rregullator i këtij tregu, ka monitoruar dhe është kujdesur për një mbikëqyrje efektive, në mbrojtje të interesave të konsumatorëve dhe ruajtjes së treguesve financiarë.

Dëshiroj të veçoj punën që është bërë në drejtim të përafrimit ligjor e rregullator me direktivat dhe acquis të BE. Autoriteti ka udhëhequr grupin negociator për Kapitullin 9 “Shërbimet Financiare”, pjesë e të cilit është dhe sektori i sigurimeve. Progresi i bërë dhe angazhimet e marra për zbatimin e rekomandimeve janë vlerësuar edhe nga Komisioni Evropian.

Autoriteti po vijon me procesin e përafrimit të akteve ligjore, përfshirë edhe kalimin në regjimin mbikëqyrës në sigurime, Solvency II, si një nga prioritetet strategjike të tij.

Arritje për Autoritetin shënoi vlerësimi gjithëpërfshirës i bërë nga Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve në Sigurime (IAIS), nga ku rezultoi një nivel i lartë përputhshmërie me Parimet Themelore në Sigurime, ICP.

Ky është një sinjal pozitiv në mbështetje të zhvillimit dhe krijon premisa për rritjen e pranisë së investitorëve ndërkombëtarë, por edhe zgjerimin e aktivitetit të aktorëve aktualë të tregut.

Aderimi në Memorandumin Shumëpalësh të Bashkëpunimit me IAIS në vitin 2022, ka mundësuar forcimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me 83 autoritete rregullatore, nënshkruese të tij.

Autoriteti, në rolin e tij si mbikëqyrës dhe rregullator i këtij tregu, ka monitoruar dhe është kujdesur për një mbikëqyrje efektive, në mbrojtje të interesave të konsumatorëve dhe ruajtjes së treguesve financiarë.

Fjala e Drejtores Ekzekutive në detyrë zj. Mimoza Kaçi në Konferencën Zhvillimi i Sektorit të Sigurimeve – Mundësitë dhe Sfidat në Evropën Juglindore”



Dhe në vijim të këtyre vlerësimeve, kam kënaqësinë të ndaj me ju lajmin e mirë, që në vitin 2025 Shqipëria do të jetë vendi pritës i Konferencës Vjetore të IAIS, aktiviteti më i rëndësishëm vjetor i sektorit të sigurimeve në nivel global. Kjo është hera e parë që ky aktivitet zhvillohet në Shqipëri dhe në rajon. Ky është tregues i qartë, për kapacitetet institucionale, besueshmërinë dhe marrëdhëniet e shkëlqyera të AMF-së me IAIS dhe rregullatorët ndërkombëtarë.

Gjatë konferencës sot, do të kemi mundësinë të ndjekim profesionistët e fushës që do të thellohen në disa tema aktuale, si roli i sigurimeve në menaxhimin e katastrofave natyrore, zgjerimi i mbulimit në sektorin e bujqësisë, sfidat dhe mundësitë për zhvillimin e mëtejshëm të sektorit të sigurimeve në Shqipëri dhe rajon.

Dëshiroj të falenderoj në mënyrë të veçantë, SECO-n dhe Bankën Botërore, për kontributin e tyre në organizimin e kësaj konference, për mbështetjen ndër vite dhe në vijimësi.

Të nderuar pjesëmarrës në përfundim të fjalës time, kam kënaqësinë të ftoj për ta përshëndetur këtë konferencë ideuesin e saj, me të cilin e nisëm bashkë këtë angazhim kaq të rëndësishëm, që kam privilegjin ta finalizoj sot. Personi i cili me profesionalizëm të lartë drejtoi Autoritetin, duke e ngritur lart reputacionin e tij dhe me të cilin pata privilegjin të bashkëpunoja. E falenderoj publikisht!

Mbyllet “Java Botërore e Investitorëve” e IOSCO-s



Gjatë periudhës 2-8 tetor u zhvillua për të shtatin vit radhazi Java Botërore e Investitorëve (WIW). Më shumë se 100 juridiksione kanë marrë pjesë në këtë fushatë, krahas disa organizatave globale dhe ndërkombëtare që i janë bashkuar fushatës për herë të parë. Bursat, ndërmjetësit e tregut, shoqatat e profesionisteve që veprojnë në tregun e investimeve si edhe palët e tjera të interesuara iu bashkuan rregullatorëve të letrave me vlerë në mbarë botën për të mbështetur një sërë iniciativash për edukimin e investitorëve që synojnë rritjen e mbrojtjes së tyre. Edhe grupi i 20 vendeve të zhvilluara G20, me Presidencën e Indisë, ka mbështetur gjithashtu Javën Botërore të Investitorëve.

Niveli i lartë i pjesëmarrjes në WIW nga e gjithë bota është tregues i qartë i prioritetit që rregullatorët dhe pjesëmarrësit e tregut po i japin edukimit financiar, duke marrë parasysh rrethanat e tyre lokale, edhe sfidat e përbashkëta me të cilat përballen investitorët me pakicë në të gjithë vendet.

Pasquale Munafò, Kryetar i Komitetit të IOSCO-s për Investitorët me Pakicë, u shpreh se: “Inovacioni financiar po hap mundësi të reja biznesi për industrinë dhe përfitime të mundshme për investitorët. Në këtë kontekst, rregullatorët, industria dhe sistemi duhet të bashkëpunojnë për të vazhduar rritjen e mbrojtjes financiare të konsumatorit në nivele të ndryshme, duke përfshirë edukimin financiar. Ndër të tjera, fushata WIW ka dhënë mesazhe kyçe mbi Crypto Asetet dhe Financat e Qëndrueshme, dy fusha në të cilat IOSCO do të vazhdojë të punojë dhe të japë udhëzimet e saj.”


Eduardo Manhães Ribeiro Gomes, Koordinator i Grupit të Punës për WIW, tha se “Rregullatorët në mbarë botën po ndërmarrin iniciativa të ndryshme financiare dhe edukimi për investitorët, duke filluar nga mesazhet dhe mjetet bazë deri te programet gjithëpërfshirëse. WIW ofron një mundësi për të shkëmbyer përvoja dhe mënyra për të vazhduar angazhimin me përpjekjet e industrisë dhe të palëve të tjera të interesuara për të promovuar njohuri, sjellje, qëndrime të shëndosha dhe praktike në mbrojtje të investitorëve.

IOSCO do të vazhdojë të shpërndajë mesazhe kyçe për edukimin dhe mbrojtjen e investitorëve si edhe nxitjen e mundësive të të mësuarit për investitorët, ndërkohë që do të vazhdojë të mbështesë bashkëpunimin me aktorë të ndryshëm nën ombrellën e fushatës WIW.

Informacione shtesë
mbi aktivitetet dhe
ngjarjet e WIW
gjenden në faqen e
internetit të WIW

<https://www.worldinvestorweek.org>

XPIMM publikon “Raportin e Sigurimeve” për gjysmën e parë të vitit 2023



Materiali i publikuar gjendet në linkun:

<https://www.oecd.org/economic-outlook/june-2023/>

Xprimm.com publikon raportin për tregun e sigurimeve në gjysmën e parë të vitit 2023 për vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, vendet e Evropës Juglindore dhe për ish republikat e Bashkimit Sovjetik. Raporti jep detaje për ecurinë e tregut të sigurimeve në 32 vende, duke përshkruar ecurinë e vëllimit të primeve të shkruar bruto, në sigurimet e Jetës dhe të Jo-Jetës, dëmet e paguara, tendencat e zhvillimit dhe ndikimet nga ngjarjet e paparashikuara të natyrës. Në raport përshkruhen edhe zhvillimet legjislative në tregun e sigurimeve për secilin vend.

BULLGARI

www.xprimm.com

Sipas shifrave zyrtare të publikuara nga Komisioni i Mbikëqyrjes Financiare të Bullgarisë, në fund të qershorit 2023, tregu i sigurimeve në Bullgari arriti në vlerën e 1.15 miliardë euro, me një rritje prej 25.9% më shumë se një vit më parë.

Sigurimet e Jetës përbënin 16.15% të totalit të tregut, me rënie rreth 1 pikë përqindje krahasuar me fundin e qershorit 2022, kur ato zinin 17.79% të totalit të tregut. Ndërsa në vlerë absolute, primet e shkruara bruto për sigurimet e Jetës u rritën me 14.4%, duke arritur në vlerën e 186.76 milionë euro.

Segmenti i sigurimeve të Jo-Jetës ishte nxitësi i rritjes së tregut, dhe linja e sigurimit MTPL ishte kontribuesi më i madh në treg. Primet e shkruara bruto për sigurimet e Jo-Jetës arritën në 969 milionë euro, me një rritje prej 28.4% në terma vjetorë. Pësia e klasave të sigurimeve motorike në portofolin e tregut u rrit me gati 3 pikë përqindjeje. Ato aktualisht përbëjnë pothuajse 59% të të gjithë primeve të shkruara bruto të tregut.

Dëmet e paguara u rritën në përgjithësi me një ritëm më të lartë rritjeje se sa primet e shkruara bruto. Në nivel tregu, dëmet arritën vlerën e 547.3 milionë euro, rreth 53.6% më shumë në terma vjetorë. Kontributin më të lartë në rritjen e dëmeve të paguara e patën kategoritë e sigurimeve motorike, në veçanti ajo e sigurimit MTPL. Dëmet e paguara për MTPL përbënin 54% të totalit të dëmeve të paguara të Jo-Jetës.

ÇEKI

www.xprimm.com

Sipas statistikave të publikuara nga Banka Kombëtare Çeke, tregu i sigurimeve në vend e mbylli tremujorin e dytë të 2023 me një vlerë të primeve të shkruara bruto prej 107.8 miliardë CZK ose rreth 4.5 miliardë euro. Kjo vlerë shpreh një rritje prej 6.4% më shumë se një vit më parë.

Dëmet e paguara nga siguruesit vendas arritën në 53.2 miliardë CZK ose rreth 2.2 miliardë euro, me një rënie prej 10.5% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Pjesa më e madhe e kësaj rënie lidhet me sigurimet e Jo-Jetës.

Sigurimi i Jetës zë rreth 30% të portofolit të primeve të shkruara bruto, rreth 25.3 miliardë CZK, me një rritje prej 1.2% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Sigurimet e Jo-Jetës kanë një vlerë prej 59.4 miliardë CZK, me rritje 7.8%.

QIPRO

www.xprimm.com

Sipas raportit të publikuar nga Shoqata e Sigurimeve të Qipros, IAC, siguruesit qipriotë realizuan një vëllim të primeve të shkruara bruto në gjashtëmuajt e parë të vitit 2023 prej 585.9 milionë euro. Kjo vlerë shënon një rritje prej 57 milionë euro ose me 11.8% në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Segmenti i sigurimeve të Jo-Jetës arriti në 292.5 milionë euro, duke u rritur me 9.8%, ndërsa segmenti i sigurimit të Jetës realizoi prime prej 293.3 milionë euro, ose 11.8% më shumë.

Vlera e dëmeve të paguara bruto ishte 248 milionë euro, me një rritje rreth 8.4% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në dëmet e paguara, vlerën më të madhe prej 118 milionë euro e zinin sigurimet e Jetës, më pas sigurimet motorike me 68.8 milionë euro, sigurimet nga aksidentet dhe shëndetësi 36.1 milionë euro, dhe sigurimi i zjarrit 15.6 milionë euro.

RUMANI

www.xprimm.com

Siç tregojnë të dhënat e Autoritetit Rumun të Mbikëqyrjes Financiare, siguruesit rumunë e përfunduan gjysmën e parë të vitit 2023 me një vlerë të primeve të shkruara bruto prej 1.83 miliardë euro, e cila ishte 3.28% më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Pjesën më të madhe të primeve e zinin ato të sigurimit të Jo-Jetës me 1.52 miliardë euro, ndërsa, sigurimet e Jetës realizuan 305 milionë euro prime.

Vlera e dëmeve të paguara arriti në 776.65 milionë euro, me një rritje prej vetëm 1.9% më shumë në terma vjetorë. Gjithashtu, Fondi i Garancisë së të Siguarave ka miratuar pagesa në vlerë prej 74.8 milionë euro. Së fundi, siguruesit e huaj që operojnë në Rumani bazuar në të drejtën për të vepruar si kompani të vendeve të Bashkimit Evropian, FOE, kanë paguar dëmshpërblime në një vëllim shtesë prej 68.3 milionë euro.

Në raport me vëllimin e primeve të shkruara bruto, sigurimet motorike patën një periudhë të përgjithshme stanjacioni, por duke shikuar më në detaje shihet se sigurimi Kasko u rrit me 17.4% në vit, ndërsa primet për sigurimin MTPL u ulën me 5.8%, në terma vjetore. Në tregun rumun të MTPL-së operojnë edhe dy filiale të huaja në sistemin FOE, të cilat i shtuan këtij totali 122.24 milionë euro, që është 2.4 herë më shumë në vit. Si e tillë, PBB për sigurimin MTPL arriti në 943.24 milionë euro, rreth 2% më shumë në terma vjetorë.

Primet e sigurimit të pronës, u rritën me 16.2% në terma vjetore, duke arritur në 199.75 milionë euro. Pjesa më e madhe e kësaj rritjeje vjen nga klasat “zjarri dhe rreziqet e lidhura”, e cila përfshin sigurimin e detyrueshëm kundër katastrofave natyrore, sigurimin vullnetar të banesave dhe sigurimin vullnetar të pronave për qëllime tregtare. Numri i kontratave aktive deri në fund të qershorit 2023 u rrit si në kontratat e sigurimeve të detyrueshme, ashtu edhe për kontratat e sigurimit vullnetar.

SERBI

www.xprimm.com

Statistikat e publikuara nga Banka Kombëtare e Serbisë tregojnë se në gjysmën e parë të vitit 2023 tregu i sigurimeve në vend realizoi një rritje prej 16.28% në terma vjetore, duke arritur në 78.56 miliardë dinarë ose rreth 670.17 milionë euro.

Tregu është i orientuar drejt sigurimeve të Jo-Jetës, të cilat zënë rreth 81% të totalit të portofolit. Peshë e tregut të sigurimit të Jetës pësoi një rënie në krahasim me një vit më parë.

Dëmet e paguara të sigurveve vendas arritën në 33.11 miliardë RSD ose rreth 282.50 milionë euro, vlerë e cila është rreth 16% më shumë krahasuar me një vit më parë. Vlen të përmendet ritmet e larta të rritjes së dëmeve të paguara të regjistruara nga disa klasa sigurimesh si mallrat në tranzit, sigurimet shëndetësore, sigurimet e udhëtimit. Ndërsa sigurimet nga aksidentet pësuan një rënie të dëmeve të paguara me rreth 1%.

SLLOVENI

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të tregut të publikuara nga Shoqata Sllovene e Sigurimeve, vëllimi i primeve të shkruara bruto të sigurveve sllovenë në gjashtë muajt e parë të 2023 u rrit me 9.5% në terma vjetore, duke arritur në 1.62 miliardë euro.

Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2023, primet e sigurimit të Jo-Jetës u rritën me 11.32% në terma vjetore, duke arritur në 1.21 miliardë euro, ndërsa primet bruto të sigurimit të Jetës u rritën me 4.32% në vit, duke arritur në 410.63 milionë euro.



Për informacion të mëtejshëm
na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al